



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 846/5 Prot.

Tiranë, më 10.03.2023

VENDIM

Nr. 19, datë 10.03.2023

“PËR MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE TË CIKLIT TË TRETË “MASTER EKZEKUTIV”, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, neni 25, pika 7, neni 42, pika 7, neni 69, pika 3, neni 80, Statutit të UMT-së neni 5, neni 12, neni 26, neni 44, neni 86, neni 95, Rregullores së UMT-së, Urdhrave të MAS nr. 590, datë 04.10.2022 dhe nr. 618, datë 14.10.2022 për hapjen e programeve të përbashkëta, si dhe bazuar në propozimin e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Senati Akademik,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë” në bashkëpunim me Universitetin “G. d’Annunzio” Chieti, Pescara, për vitin akademik 2023-2024, janë 45 kuota.
2. Kuotat e pranimit në programet e përbashkëta të studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe të ciklit të tretë “Master Ekzekutiv”, për vitin akademik 2023-2024, sipas pikës 1 të këtij vendimi, pasqyrohen në tabelën 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

KRYETARI

ARBËNSHATA



Tabela Nr. 1

UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË, KUOTAT E PRANIMIT NË PROGRAMET E PËRBASHKËTA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË "MASTER PROFESIONAL" DHE TË CIKLIT TË TRETË "MASTER EKZEKUTIV", PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024

Nr.	Fakulteti	Cikli i studimit	Programi i Studimit	Kuota
1	F. i Mjekësisë Dentare	II	Master Profesional/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Parë në "Higjenë Dentare dhe Terapi Parodontale jo Kirurgjikale"	30
2	F. i Mjekësisë Dentare	III	Master Ekzekutiv/Master Ndërkombëtar i Nivelit të Dytë në "Implanto Protetikë"	15